

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skandali me SHISH, ekspertja kanadeze e sigurisë: Zbuloni nëse ka të bëjë me një individ, apo me një rrjet më të gjerë
ADRESA	https://a2news.com/shqiperia/aktualitet/skandali-me-shish-ekspertja-kanadeze-e-sigurise-zbuloni-nes-i1186023
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 16:17:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 16:13:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2d20ea27a338143ac3c3ebfc76d69212ce9a0e8a36d30e4d95bae82e07048035
TEKSTI	8b789b30011e4a1705b5a2510de4289953fbfcb10f7f38bf2b88891ef1d269de
PAMJA	6e88e5d18067241e4afaf13b9fb9f9c684593fe9ab41bed52666aecc088565c6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	735b9e47fdda2599f155278f74f2e647af4c81d4564bccfb055056d546aad032
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fceb101e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/735b9e47fdda2599f155278f74f2e647af4c81d4564bccfb055056d546aad032>


PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Skandali me SHISH, ekspertja kanadeze e sigurisë: Zbuloni nëse ka të bëjë me një individ, apo me një rrjet më të gjerë

Nga A2 CNN
28 Shtator 2026, 18:13 | Aktualitet



Një ngjarje fatkeqe, e ka cilësuar ekspertja kanadeze e sigurisë kombëtare, Stephanie Carvin, skandalin me drejtoreshën e SHISH, Vlora Hyseni, e cila dyshohet se i ka dorëzuar informacione sekrete biznesmenit Ergys Agasi, i arrestuar për dosjen "AKSHI".

Në një intervistë me Rrethetëqark në A2 CNN me Xhevahir Qardakun, ajo bëri të ditur se kjo është shqetësuese dhe dëmton besimin.

"Pa e mbivlerësuar ekspertizën time mbi politikën shqiptare, mund të them se këto janë ngjarje fatkeqe. Në çdo vend, kur kemi atë që në fushën e sigurisë quhet "kërcënim i brendshëm", situata është serioze. Bëhet fjalë për një person që ka akses të privilegjuar në informacion dhe më pas e keqpërdor atë, duke e shkatërruar, ndryshuar ose transmetuar të persona që nuk duhet ta kenë. Kjo është gjithmonë shqetësuese dhe dëmton besimin", deklaroi tha ekspertja në A2 CNN.

E pyetur se çfarë duhet të bëjë Shqipëria në një rast kaq sensitiv, ajo u shpreh se e rëndësishme është rikthimi i besimit të publiku, prandaj sipas saj duhet një hetim i plotë dhe transparent që të kuptohet nëse kemi të bëjmë vetëm me një individ apo një rrjet.

"Është gjithmonë një sfidë, sepse kemi të bëjmë me operacione shumë sekrete dhe, në të njëjtën kohë, me nevojën për drejtësi publike. Jo gjithmonë është e lehtë, sepse gjatë hetimeve mund të dalin në publik informacione operacionale. Prandaj duhet treguar kujdes. Por kur një ngjarje e tillë trondit besimin, gjëja më e rëndësishme është rikthimi i këtij besimi. Një hetim i plotë dhe sa më transparent që të jetë e mundur është shumë i rëndësishëm. Hetimi duhet të jetë i ndershëm, por edhe efikas, në mënyrë që e vërteta të dalë sa më shpejt dhe çështja të mos zvarritet. Gjithashtu, nëse ka indicie për lidhje të tjera, duhet të përcaktohet nëse kemi të bëjmë me një individ që ka vepruar i vetëm apo me një rrjet më të gjerë", theksoi ajo.

Sipas ekspertës, Stephanie Carvin, raste të tilla dëmtojnë jo vetëm reputacionin e institucioneve, por edhe sigurinë kombëtare. Ajo theksoi se Shqipëria nuk është i vetmi vend anëtar i NATO-s që përballet me raste të tilla, pasi edhe Kanadaja ka pasur disa raste të ngjashme.

"Shqipëria nuk është i vetmi vend anëtar i NATO-s që përballet me raste të tilla. Edhe Kanadaja ka pasur disa raste të ngjashme. Në Kanada kemi pasur raste ku zyrtarë të lartë të policisë janë akuzuar për transmetim informacioni të krimi i organizuar. Edhe këtë vit, një praktikant në selinë e NATO-s u arrestua nën dyshimin se po përpiqej të mblidhte informacione, që sipas raportimeve mediatike mund t'i kalonin Kinës. Pra, këto janë situata me të cilat përballen vende të ndryshme, veçanërisht kur bëhet fjalë për informacion të specializuar që mund të jetë me interes për krimin e organizuar apo për shtete të tjera. Ajo që ka vërtet rëndësi është mënyra se si hetohen këto raste, nëse e vërteta bëhet publike dhe nëse personat përgjegjës mbahen para përgjegjësisë, nëse fajësia e tyre provohet. Kjo është mënyra se si mund të rikthehet besimi i publikut", shtoi ajo.

TE FUNDIT

Fier, zjarr i madh në Kreshpan. rrezikohet edhe masivi pyjor me pisha

Partitë pa marrëveshje për presidentin e ri tekta afati po përfundon

Iraku kërkon rrugë të reja për eksportin e naftës pas bllokimit të Ngushticës së Hormuzit

Sherri me avokatët, GJKKO në kolaps prej rregullores, 3 javë pa gjyqe

MË TË VIZITUARAT

PD kërkon pezullimin e territoriale, PS refuzon të presë konsultimet me bash...

Ukraina në vështirësi financiare, i duhen edhe 20 miliardë dollarë

Zjarri i madh në Pogradec, flakët drejt masivit me pisha

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Ruisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

Ajo përmendi rastin e ish-zyrtarit kanadez Cameron Ortis, i akuzuar për transmetim informacioni tek elementë kriminalë. Sipas Carvin, informacione të tilla mund t'u tregojnë grupeve kriminale se si po hetohen dhe t'i ndihmojnë të shmangin përgjimet apo hetimet për trafik droge, pastrim parash dhe aktivitete të tjera të paligjshme.

"Kur dikush abuzon me informacionin në këtë mënyrë, dëmton institucionin në disa drejtime. Fillimisht dëmton reputacionin e organizatës, por gjithashtu mund të pengojë drejtpërdrejt hetimet kriminale dhe punën e shërbimeve të inteligjencës", tha ajo.

Carvin paralajmëroi gjithashtu se raste të tilla mund të ndikojnë edhe në marrëdhëniet me aleatët ndërkombëtarë. Sipas saj, nëse besimi cenohet, partnerët mund të hezitojnë të ndajnë informacione sensitive nga frika se ato mund të bien në duar të gabuara. **(A2 Televizion)**

A2 CNN Livestream

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Zjarr i madh në Topojë, flakët rrezikojnë banesën



Përmbillet "Shkolla Rinore Ballkanike 2026", ambasadori turk: Forcojmë marrëdhëniet me Shqipërinë



Mësuesi i historisë! Me shpenzimet e tij për të dhënë mësim mes malesh




Pas fazës së parë, Universiteti i Vlorës po tërheq edhe studentë të huaj




Unioni i Gjyqtarëve refuzon ftesën e Ramës për konsultim: Presim vendimin e Kushtetueses

Në Vlorë me kampera, qyteti bregdetar që vijon të tërheqë turistët e huaj

Latest Videos



"Vlora Hyseni" mbledh shtetin dhe SPAK, çfarë ndodhi në Këshillin e Sigurimit?



U lanë jashtë Broja e Bajrami, Vata: Të jenë pjesë e grupit edhe pse nuk janë në formën më të mirë



Ka ardhur koha që të kemi një trajner shqiptar? Vata: Nuk shikojmë figurat e rëndësishme...



Shqipëria e nis mbarë Ligën e Kombeve, Vata: Me energjinë e Silvinjos ishte ndryshe, humbjet para...

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim


Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulo
Imagjinatë
Dëshmi



Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga Mediaset

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.